



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve

Blvd. Dëshmorët e Kombit Nr.2

Tel (35542)23177

E-mail: { HYPERLINK mailto:postmaster@mepp.tirana.al }

Internet: HTTP://WWW.MEPP.GOV.AL.

Fax(35542)3405

URDHER

Nr. 291 Date 2.6.2000

Per krijimin e shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes" SHPK Kuçove

Ne baze te nenit 102 te Kushtetutes, mbeshtetur ne ligjin nr.7926 date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me ligjin nr.8158 date 07.11.1996 dhe ligjin nr.8237 date 01.09.1997, ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", mbeshtetur ne nenin 10 te Statutit te shoqerise "Albanian Petroleum Corporation" (APC) SH.A. Tirane dhe ne propozimin e shoqerise "Albanian Petroleum Corporation" (APC) SH.A. Tirane me nr.474 date 15.05.2000

URDHEROJ:

1. Krijimin e shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes" SHPK, me seli ne Kuçove, me kapital themeltar 500 000 (peseqindmije) leke.
2. Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar te shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes" SHPK Kuçove zoterohen nga shoqeria "Albanian Petroleum Corporation" (APC) SH.A. Tirane.
3. Ngarkohet Drejtori i Pergjithshem i shoqerise "Albanian Petroleum Corporation" (APC) SH.A. Tirane, Z. Kastriot Bejtaj, te nenshkruaje aktet e themelimit te shoqerise "Uzina Mekanike e Naftes" SHPK Kuçove.
4. Per zbatimin e ketij urdheri ngarkohet Drejtoria e shoqerise "Albanian Petroleum Corporation" (APC) SH.A. Tirane.
Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE

Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme

URDHER

Nr. 383 Date 1d.11.2004

PER

NDRYSHIME NE AKTIN E THEMELIMIT DHE STATUTIN E SHOQERISE
“UZINA MEKANIKE E NAFTAES” SH.P.K. KUÇOVE

Drejtuar: **SHOQERISE “UZINA MEKANIKE E NAFTAES” SH.P.K. KUÇOVE**

Ne baze te nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002 “Per nje ndryshim ne Ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 “Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare”, ndryshuar me ligjet perkatese; Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”; Vendimit nr. 28, date 16.01.2003 te Keshillit te Ministrave “Per likujdimin e Shoqerise “Albanian Petroleum Corporation” Sh.a. Tirane, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise,

URDHEROJ

I. Ndryshimin e Aktit te Themelimit te Shoqerise “Uzina Mekanike e Naftes ” Sh.p.k. Kucove si me poshte:

Neni 2, shfuqizohet

Neni 5, ndryshohet dhe behet si vijon:

Kapitali i Shoqerise “Uzina Mekanike e Naftes ” Sh.p.k. Kucove eshte 143,842,290 leke dhe i zoteruar teresisht nga Ministria e Ekonomise.

II. Ndryshimin e Statutit te Shoqerise “Uzina Mekanike e Naftes ” Sh.p.k. Kucove si me poshte:

Ne nenin 1, shfuqizohet shprehja:

“Shoqeria “Uzina Mekanike e Naftes” Sh.p.k. Kucove eshte shoqeri e kontrolluar nga shoqeria “APC” SH.A Tirane.

Neni 8, ndryshohet dhe behet si vijon:

Kapitali themeltar eshte i ndare 143,842 pjese te barabarta, secila me vlere nominale 1,000 leke. Kuotat e Shoqerise “Uzina Mekanike e Naftes ” Sh.p.k. Kucove zoterohen ne masen 100% nga Ministria e Ekonomise.

Neni 12, riformulohet:

Te gjitha kompetencat e asamblese se pergjithshme te parashikuar nga Ligji nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ushtrohen nga Ministri i Ekonomise me cilesine e ortakut te vetem.

Neni 33 shfuqizohet

III. Urdherat nr. 111, date 22.04.2004 dhe nr. 275, date 09.08.2004 shfuqizohen

II. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme dhe Drejtoria Juridike te kryejne ne Gjykate proçedurat e depozitimit te ndryshimeve ne aktet e themelimit te shoqerise.

Ky urdher hyn ne fuqi ne fuqi menjehere

